



Planuar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Delivery	01.07.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3859/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.491/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.491/2022 të datës 31.05.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komunës së Skenderajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.491/2022 e datës 31.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi kandidat për shërbim civil, më datë 31.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3167/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Konkursit të shpallur nga Komuna e Skenderajt me numër reference RN00008124, për grup Specialist i Administrimit të Përgjithshëm-Asistent Administrativ 4, me pretendimin së Komisioni Vlerësues nuk e ka vlerësuar drejtë, mungesë të transparencës dhe vonesa të pakuptimta në vlerësim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Skenderajt, ndërsa kjo e fundit më datë 17.06.2022 dhe 27.06.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokolli 3167/2022 të datës 31.05.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; CV-në e ankuesit; Emalin e datës 10.05.2022 nga ankuesi; Emalin e datës 10.05.2022 nga [simbj@rks-gov.net](mailto:simbj@rks-gov.net) për ankuesin; Përgjigjen në ankesë e datës 25.05.2022 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt për ankuesin; Njoftimin e datës 24.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 17.06.2022 dhe 27.06.2022; Njoftimin e datës 14.06.2022; Konkursin me Nr. Reference RN00008144 për grup Specialit i Administrimit të Përgjithshëm të datës 20.01.2022; Vendimin me Nr. 02-111/01-0002739/22 i datës 17.01.2022 mbi lejimin e shpalljes së konkursit; Konkursin me Nr. Reference RN00008124 për grup Specialit i Administrimit të Përgjithshëm i datës 19.01.2022; Formularin për renditjen përfundimtare të kandidatëve për konkursin me Nr. Reference RN00008124; Listën e aplikativë për konkursin me Numër Reference:RN00008124; Njoftimin e datës 08.03.2022 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për fazën e verifikimit paraprak për konkursin me Numër Reference RN00008144; Diplomën me Nr.3 të datës 09.10.2017 të ankuesit; Certifikatën e datës 03.06.2017, shtator 2020; Certifikatën nga 01.04.2021 deri 30.09.2021; Vërtetim pune i datës 30.04.2016; Vërtetim i datës 02.10.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Skenderajt më datë 19.01.2022 ka publikuar njoftimin për shpalljen e konkursit me numër reference RN00008124 për grup Specialit i Administrimit të Përgjithshëm-Asistent Administrativ 4, i hapur për aplikim nga data 09.02.2022 deri me datë 23.02.2022, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. I njëjti është përfshirë në testin me shkrim dhe në vlerësimin e jetëshkrimit (CV-së). Në bazë të Formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve, asnjë prej kandidatëve nuk ka arritur të marrë 70 pikë, e mbi këtë arsye Kryetari i Komisionit të Pranimit me datë 24.05.2022 ka publikuar Njoftimi me Nr.02-112/01-0023390/22 së procedura e konkurrimit sipas Konkursit me numër reference RN00008124 përfundon pa fitues.

Ankuesi parashtron ankesë më datë 18.05.2022, ndërsa me datë 25.05.2022, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt përcjell përgjigje në ankesë duke njoftuar ankuesin se konkursi për pozitën *asistent administrativ 4* është anuluar pasi që asnjë nga kandidatët nuk ka arritur të vlerësohet me së paku 70 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni Vlerësues nuk e ka vlerësuar drejtë, mungesë të transparencës dhe vonesa të pakuptimta në vlerësim.

Në bazë të konkursit me numër reference RN00008124 për grup Specialit i Administrimit të Përgjithshëm-Asistent Administrativ 4, kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë: -Arsiminimi i kërkuar: Diplomë/a e shikollës së mesme apo ekuivalente me to. Kualifikime të posaçme formale: Nuk ka; Përvojë e punës



*e kërkuar: Nuk kërkohet, andaj, sipas këtyre kritereve rrjedhë se vlerësimi i kandidatëve në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit bëhet vetëm tek kriteri i arsimimit, rrjedhimisht meqenëse nuk janë kërkuar kualifikime të tjera të posaçme dhe përvojë e punës, kandidatët nuk vlerësohen lidhur me këto kërkesa. Në këtë kuptim, si dhe duke ju referuar provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni i Pranimit ka vlerësuar ankuesin vetëm për nivelin e arsimimit me pikë maksimale gjithsej tetë (8) pikë dhe se vlerësim të njëjtë ka dhënë për të gjithë kandidatët që kanë plotësuar kriterin në fjalë, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 22 paragrafin 3 dhe paragrafin 4 nën paragrafi 4.1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht Kolegji konstaton se është i pa bazuar pretendimi ankimor se Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësim jo të drejtë dhe tendencioz.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka vlerësuar se ankuesi në testimin me shkrim ka arritur të marrë gjithsej 49 pikë duke kaluar pragun e pikëve të përcaktuar me nenin 22 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo bazuar në vlerësimet e testit me shkrim dhe vlerësimin e jetëshkrimit ankuesi ka grumbulluar vetëm 57 pikë, të pamjaftueshme për t'iu nënshtruar intervistës me gojë, sepse, sipas nenit 34 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 23 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë me gojë.

Po nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit vëren se asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur të marrë 70 pikë, kështu mbi këtë fakt organi punëdhënës ka përfunduar procedurën e rekrutimit pa fitues, duke vepruar në pajtim me nenin 25 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar se paku me shtatëdhjetë 70 pikë, Komisioni i Pranimit, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit pa fitues. Njësia Përgjegjëse publikon njoftimin për përfundimin e procedurës të konkurrimit pa fitues, në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.*

Bazuar në konstatimet si me lart, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.491/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

